



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 36

Nr.23 Vendimi

Dt 5.12.2014

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues te përbërë prej gjyqtareve:

**Kryesuese : Rilinda SELIMI**  
**Anëtare : Alkelina GAZIDEDJA**  
**Anëtare : Blerona HASA**

Asistuar nga sekretare gjyqësore Afede Runaj, shqyrtoi në Tiranë, në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. 36 rregj. që u përket paleve:

**PADITËSE:** Herila Çela, e bija e Asqerit dhe Ervehese, e datelindjes 05.07.1972, lindur ne Vlore, banuese ne Vlore, lagjen "Isa Boletini", rruga "Sadik Zotaj", gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlore, përfaqësuar me prokurë nga avokate Erinda Ballanca, nr license 618.

**I PADITUR:** Këshilli i Lartë i Drejtësisë i përfaqësuar ne gjykim nga Znj. Vojsava Osmanaj, autorizimi date 11.07.2014

**OBJEKTI:** Anullimi i vendimit Nr. 105, datë 21.7.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 30, 42, 147/6 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;

Neni 6/1 i Konventës Evropiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”;

Nenet 31, 32, 33, 34, 35, 36/2 i Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 8811, datë 17.05.2001, “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Lartë të drejtesisë”, me ndryshime, neni 16;

Neni 10, 2 b, 15, 17 1 a, 40 a, i ligjit nr. 49/2012 i ligjit “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeje administrative”;

Vendim nr. 199, i Keshillit të Lartë të Drejtesisë “Mbi kriteret matese të veprimtarisë gjyqësore”

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi paditësen, që në diskutimin e saj përfundimtar kërkoi:

-Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit Nr. 105 datë 21.07.2014 të Keshillit të Lartë të Drejtesisë, si akt i dale në kundërshtim me ligjin.

Dëgjoi përfaqësuesin e palës së paditur, Keshillit të Lartë të Drejtesisë, që në diskutimin e tij përfundimtar kërkoi:

-Rrëzimin e kerkese-padisë si të pabazuar në ligj e prova.

Dhe vlerësoi çështjen në teresi:

## VËREN

Paditesja Herila Cela, me detyre gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padinë objekt gjykimi duke kundërshtuar vendimin Nr. 105 date 21.07.2014 të palës së paditur, K.I.D. lidhur me masën disiplinore "verëjtje me paralajmërim" të dhënë ndaj saj.

Paditesja ushtron detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Inspektoriati i Keshillit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në ligjin Nr. 8811 date 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Lartë të Drejtësisë" i ndryshuar, dhe Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Keshillit të Lartë të Drejtësisë" ka realizuar verifikimin e disa ankesave të ardhura nga Kico Billa, Odeta Haxhi Dogga, Myzejen Zyka, dhe Dodona Ramadani pranë këtij Keshilli në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës Herila Cela e në mënyrë të vecantë me pretendimin e zvarritjes së proceseve gjyqësore. (faktet e provuara në gjykim dhe të pranuar nga palët)

Inspektimi i parë është kryer në lidhje me ankesën e shtetasit Kico Billa për zvarritje të procesit gjyqësor. Kontrolli është ushtruar në baze të urdherit të inspektimit të datës 04.09.2012 dhe datës 22.10.2012 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga kontrolli i çështjes gjyqësore, për të cilën është paraqitur ankesa nga shtetasi Kico Billa përfaqësues i njërit prej palëve në proces me lidhje gjinore me të shtetasen Violeta Serjani, kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar çështja civile me nr. 3120 akti date 04.10.2011, me palë ndërgjyqëse: Padites Violeta Serjani, të paditur Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me objekt: "Detyrim për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme". Pas dorëheqjes së një gjyqtari tjetër me date 17.10.2011 në këtë çështje, me shortin e hedhur me date 18.10.2011 i ka kaluar gjyqtarës Herila Cela. Me date 24.10.2011 gjyqtarja ka vendosur kalimin e çështjes në seancë përparimtare me date 14.12.2011, me arsytimin "për shkak të ngarkesës shumë të madhe të punës". Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 26 ditë dhe janë zhvilluar 6 seanca përparimtare, konkretisht në datat 14.12.2011, 15.02.2012; 05.03.2012; 10.04.2012; 03.05.2012 dhe 10.05.2012, në seancën e pestë, të datës 03.05.2012 është konstatuar se dy personat e tretë të thirrur për gjykim nga Gjykata e Apelit Vlorë, Bede Veliq dhe Aliko Veliq

kishin vdekur. Gjyqtarja e ka konsideruar kete fakt si te mete te padise dhe i ka lene paditeses 7 dite, qe deri ne seancen e rradhes, te dates 10.05.2012 qe te sillte deshmive e trashegimise.

Ne seancen e dates 10.05.2012 gjyqtarja pasi ka konstatuar se te metat e padise (deshmia e trashegimise) nuk eshte plotesuar ka vendosur kthimin e padise ne baze te nenit 154/a te K.Pr.Civile. Ceshnja eshte riparqitur para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore me date 04.06.2012 dhe pa short i ka kaluar gjyqtares Herila Cela. Gjykimi ka zgjatur 1 muaj, me 2 senaca pergatitore date 25.06.2012 dhe 04.07.2012, ne seancen e dates 04.07.2012 perfaqesuesi i pales Kico Billa ka depozituar kerkese me shkrim per perjashtimin e gjyqtares. Gjyqtarja me vendim ka pranuar kerkesen per perjashtim bazuar ne nenet 74, 76 te K.Pr.Civile.

Sa me sipër është konkluduar se, nga ana e gjyqtares Herila Cela është konstatuar zvarritje e pajustificuar dhe e perseritur e veprimeve procedurale, te kryera gjate ushtrimit te funksionit prej saj, te cilat mund te sjellin pasoja per te drejten kushtetuese te paleve per nje proces te rregullt ligjor berenda nje afati te arsyeshem. Ky konkluzion bazohet ne argumentet e meposhtem:

- a) Gjykimi i ceshntjes ka zgjatur per nje periudhe prej 6 muaj e 26 dite, ne shkelje te afatit 6 mujor te parashikuar ne vendimin e K.I.D-se "Mbi kriteret matese te veprimtarise gjyqesore".
- b) Seancen e dyte ne gjykimin e pare gjyqtarja e ka planifikuar me date 15.02.2012, pra pas 2 muajsh e 1 dite. Ne kete rast, nuk jepet asnje shpjegim prej gjyqtares per afatin e gjate te planifikimit te seances, per rrjedhoje ky afat eshte i pajustificuar.
- c) Vendimmarja e gjyqtares per lenien e afatit 7 dite paditesit per plotesimin e te metave, sjelljen e deshmive te trashegimise, eshte ne shkelje te neneve 154/a dhe 199 te K.Pr.Civile.

Se pari, nuk ka reference te qarte ligjore ku eshte bazuar gjyqtarja, qe konsideron si "te mete te padise". sjelljen e deshmise se trashegimise me qellim "kalimin procedural", i cili eshte nje veprim procedural qe parashikohet nga neni 199 i K.Pr.Civile. Ne nje rast te tille, gjykata eshte e detyruar te therrase ne gjykim trashegimtarete e pales se vdekur, te cilet legjitimohen si pale ne gjykim. Ne zbatim te neneve 388 te K.Pr.Civile dhe 348 te K.Civil. Kodi i Procedures Civile parashikon qe nga dita qe gjykata jep nje vendim perfundimtar civil e deri ne ditën qe ai te marre forme te prere pa u ankimuar, duhet te kalojne 15 dite. Pra rezulton se afati qe i ka lene gjyqtarja

paditese per sjelljen e deshmise se trashegimise ishte objektivisht dhe ligjerisht i pamundur per t'u realizuar prej perfaqesuesit te saj.

Se dyti, gjyqtarja Herila Cela nuk ka zbatuar dispozitat urdheruese procedurale te sanksionuara ne nenin 297 germa "c" te K.Pr.Civile ne te cilin parashikohet se: "Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur, njera nga palet vdes ose mbaron personi juridik".

Se treti, ne gjykimin e dyte gjyqtarja ka pranuar kerkesen e pales paditese per perjashtimin e saj, pa asnje shkak ligjor te parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile. Konkludohet se, nga ana e gjyqtares Herila Cela eshte konstatuar zvarritje e pajustificuar dhe e perseritur e veprimeve procedurale, te kryera gjate ushtrimit te funksionit prej saj, te cilat mund te sjellin pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve.

Janë zhvilluar 6 seanca pregatitore. **Seancat janë shtyrë për shkak ligjore.** Në seancën e gjashtë, gjyqtarja ka vendosur "Kthimin e akteve palës paditëse për shkak të mosplotësimit të të metave, konkretisht mosparaqitjen e dëshmisë së trashëgimisë së të paditurve".

Vendimi i gjyqtares për kthimin e akteve nuk është ankimuar nga palët dhe ka marrë formë të prerë. Kjo çështje gjyqësore është riparaqitur në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë një muaj më vonë dhe pa short i ka kaluar për gjykim gjyqtares Herila Çela.

Këtë herë çështja gjyqësore ka zgjatur një muaj, gjatë të cilit janë zhvilluar dy seanca.

Përfaqësuesi i palës paditëse, ankuesi Kiço Billa, ka paraqitur në seancën e dytë përgatitore kërkesë për përjashtimin e saj si gjyqtare, nga gjykimi i kësaj çështje civile. Në të njëjtën seancë gjyqësore eshte vendosur prej saj te heq dorë nga gjykimi i çështjes civile.

**Relacioni i dyte** i eshte derguar Ministrin te Drejtesise me shkresen nr. 262/1 prot., date 20.03.2013 per ceshtjen civile me ankuese Odeta Haxhi (Dogga). Nga verifikimi qe ka bere Inspektorati i Keshillit te Larte te Drejtesise, ne zbatim te urdhrin te verifikimit te dates 18.02.2013, mbi verifikimin e ankeses se paraqitur nga shtetasja Odeta Haxhi (Dogga), per veprimtarine gjyqesore te gjyqtarit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, Herila Cela, per zvarritje gjykimi, kane rezultuar faktet e meposhtme:

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte regjistruar ceshtja civile nr. 1461 akti. date 22.02.2011 me pale ndergjyqese: Padites Hristi Dogga, te paditur Edmond Beno, person i trete: Banka Popullore Himare, me objekt: "Detyrimin e te paditurit per shperblim per perdorim sendi, si dhe te ardhurat nga dhenia me qira e sendit ne bashkepronesi". Me shortin e hedhur me date 22.02.2011 ceshtja i ka kaluar gjyqtares Herila Cela. Me date 24.02.2011 gjyqtarja ka vendosur kalimin e ceshtjes ne seance pergatitore me date 24.03.2011. Gjykimi ka zgjatur 1 vit. 9 muaj e 5 dite dhe jane zhvilluar 3 seanca pergatitore dhe 20 seanca gjyqesore. 2 seanca gjyqesore jane shtyre per shkak te moskthimit te fletethirrjeve nga posta: 10 seanca gjyqesore jane shtyre me kerkese te ndryshme te paditeses dhe avokates se saj: 3 seanca gjyqesore jane shtyre me kerkese te avokatit mbrojtës te te paditurit: 3 seanca gjyqesore jane shtyre mbasi gjyqtarja nuk eshte paraqitur ne pune per shkaqe shendetore, 2 seanca gjyqesore jane shtyre mbasi kane rezultuar festa zyrtare dhe 1 seance gjyqesore eshte shtyre me kerkese te ekspertit teknik. Nga 23 seancat e planifikuara, 4 prej tyre jane shtyre mbi 1 (nje) muaj e gjysme. Sa me sipër eshte konkluduar se nga ana e gjyqtares Herila Cela eshte konstatuar zvarritje e pajustificuar dhe e perseritur e veprimeve procedurale, te kryera gjate ushtrimit te funksionit prej saj, te cilat mund te sjellin pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve. Ky konkluzion bazohet ne argumentet e meposhtem:

- a) Gjykimi i ceshtjes ka zgjatur per nje periudhe prej 1 vit 9 muaj e 5 dite, ne shkelje te afatit te caktuar nga vendimi i KLD-se "Mbi kriteret matese te veprimtarise gjyqesore".
- b) Organizimi jo i mire i punes nga gjyqtarja ka ndikuar qe gjykimi te mos perfundoje brenda nje afati kohor me te arsyeshem.

**Relacioni i trete** i eshte derguar Ministrit te Drejtesise me shkresen nr.262/2 prot., date 30.04.2013 (per ceshtjen civile me ankuese Myzejen Zyka). Nga verifikimi qe ka bere Inspektorati i Keshillit te Larte te Drejtesise, ne zbatim te urdhrat te verifikimit te dates 27.04.2011, mbi verifikimin e ankeses se paraqitur nga shtetasja Myzejen Zyka, per veprimtarine gjyqesore te gjyqtares te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, Herila Cela, per zvarritje gjykimi, kane rezultuar faktet e meposhtme:

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte regjistruar ceshtja civile nr. 778 akti date 29.12.2009 me pale ndergjyqese, Padites: Muhamet Tigani, etj., te paditur: Qamil Ferhataj, etj., me objekt: Goditje per falsitet te vendimit nr.80 date 30.05.1995, te Komisionit te Kthimit dhe

Kompesimit te Pronave Vlore. Kundershtimin (shfuzqizimin) e vendimit nr.77 date 13.04.1995. te Komisionit te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Vlore dhe detyrimin e te paditurve te njohin pronar mbi nje siperfaqe trualli 1344 m2, trashegimtarete ligjore te ish pronareve z. Emin Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani. C'regjistrimin e siperfaqes prej 1344 m2 ne emer te te paditurve dhe regjistrimin e saj ne emer te trashegimtareve te ish pronareve Emin Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani ne Zyrat e rregjisitrimit te pasurive te Paluajtshme Vlore. Me shortin e hedhur me date 12.01.2010 ceshtja i ka kaluar gjyqtares Herila Cela, e cila ka caktuar seancen pergatitore me date 01.02.2010. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 10 muaj e 10 dite dhe jane zhvilluar 5 seanca pergatitore dhe 26 seanca gjyqesore. Nje nga seancat pergatitore eshte zhvilluar ne prani te paleve dhe me vendimin e dates 19.04.2010, gjykata ka vendosur kalimin e ceshtjes ne seance gjyqesore per me date 12.05.2010, dhe 4 (kater) seancat e tjera nuk jane zhvilluar per shkaqe: 3 seanca pergatitore jane shtyre per njoftime te paleve, 1 (nje) seance pergatitore per mungese te gjyqtares e cila ka pasur nje fatkeqesi familjare. Ne 26 seanca gjyqesore rezulton se. 13 seanca gjyqesore jane zhvilluar ne prani te paleve dhe 13 seanca nuk jane zhvilluar per keto shkaqe:5 seanca jane shtyre me kerkese te pales se paditur; 2 seanca jane shtyre jane shtyre per t'i dhene kohe te paditurve per te paguar ekspertin; 1 seance eshte shtyre per mungese te paditurit sepse ishte shtruar ne spital; 2 seanca gjyqesore jane shtyre per mungese te gjyqtares, per arsye shendetesore, raport mjekesor; 2 seanca jane shtyre per njoftime; dhe 1 seance eshte shtyre me kerkese te pales paditese.

Sa me siper eshte konkluduar se nga ana e gjyqtares Herila Cela eshte konstatuar zvarritje e pajustificuar dhe e perseritur e veprimeve procedurale, te kryera gjate ushtrimit te funksionit prej saj, te cilat mund te sjellin pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve. Ky konkluzion bazohet ne argumentet e meposhtem:

- a) Gjykimi i ceshtjes ka zgjatur nga data 12.01.2010 - 22.11.2011, per nje periudhe prej 1 vit, 10 muaj, e 10 dite, ne shkelje te afatit te caktuar nga vendimi i KLD-se Mbi kriteret matese te veprimtarise gjyqesore.
- b) Organizimi jo i mire i punes nga gjyqtarja ka ndikuar qe gjykimi te mos perfundoje brenda nje afati kohor me te arsyeshem.

**Relacioni i katert** i eshte derguar Ministrit te Drejtesise me shkresen nr.2372 prot. date 26.08.2013 (per ceshtjen civile me ankuese Dodona Ramadani). Nga verifikimi qe ka bere Inspektorati i Keshillit te Larte te Drejtesise, ne zbatim te urdhrave te verifikimit te dates 15.04.2011 dhe 14.12.2012 mbi verifikimin e ankeses se paraqitur nga shtetasja Dodona Ramadani, per veprimtarine gjyqesore te gjyqtarit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, Herila Cela, kane rezultuar faktet e meposhtme:

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte regjistruar ceshtja civile nr. 3950 akti date 29.12.2009 me pale ndergjyqese, Padites: Dodona Ramadani, kunder te paditurit: Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, me objekt: Ndryshim i pikes 1 te vendimit nr 73 date 23.02.1995, te Komisionit te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, kthimin ne natyre te siperfaqes prej 225 m2, ne emer te trashegimlensit Isa Ramadani, vendimit nr.73 date 23.02.1995, ne emer te Resul Ramadani per siperfaqen 225 m2, ne piken 1/b, vendimin nr.88 date 04.10.1995 ne emer te Brahim Ramadani, ne piken 1/b per siperfaqen 500 m2. Me shortin e hedhur me date 21.01.2010 ceshtja i ka kaluar gjyqtares Herila Cela. Me vendimin nr.697 date 25.03.2011 gjyqtarja ka vendosur: Rrezimin e padise qe i perket: paditeses Ilda Bejaj, e paditur: Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Vlore me objekt: Ndryshimin e pikes 1/b te vendimit me nr.73 date 23.02.1995, KKKPronave Vlore, Kthimin ne natyre te siperfaqes prej 225 m2 ne emer te trashegimlensit Resul Ramadani, Gjyka e Apelit Vlore me vendimin nr. 160 date 05.03.2013 ka vendosur prishjen e vendimit nr.697 date 25.03.2011 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore. Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 3 muaj, dhe jane zhvilluar 5 seanca pergatitore dhe 21 seanca gjyqesore. Ne 5 seanca pergatitore, 2 seanca pergatitore jane zhvilluar, 2 seanca pergatitore jane shtyre per mosparaqitjen e gjyqtares (rast vdekje dhe nje rast raport mjekesor), 1 seance eshte shtyre per njoftimin e Avokatures se Shtetit. Ne 21 secat gjyqesore, 10 seanca jane zhvilluar, 3 seanca jane shtyre per t'u dhene kohe eksperteve per te pergatitur aktin, 3 seanca jane shtyre per njoftim palesh ndergjyqjese, 2 seanca jane shtyre me kerkesen e paditeses per te marre avokat, 1 seance per te rregulluar te metat e padise, 2 seanca jane shtyre per mungese te gjyqtares pas ka qene me raport mjekesor. Gjyqtarja Herila Cela me vendim te ndermjetem ne daten 17.11.2010, bazuar ne nenin 159 te Kodit te Procedures Civile, ka vendosur vecimin e ceshtjes civile me nr.3999 akti date 28.12.2009, date 28.12.2009, qe i perket kerkueses Ilda Bejaj, per ndryshimin e nr.73 date 23.02.1995, KKKPronave Vlore, Kthimin ne natyre te siperfaqes prej 225 m2 ne emer te trashegimlensit Resul Ramadani. Kjo ceshtje e vecuar nga gjyqtarja ne



shortin e hedhur nga gjykata me date 20.01.2011 i ka kaluar gjyqtarit Shkelzen Selimi i cili pasi mban ne dore per nje periudhe 1 muaj e 10 dite, ne seance pergatitore urdheron kryesekretarin qe te beje kalimin e akteve tek gjyqtarja Herila Cela pasi ne vendimin e ndermjetem te vecimit te ceshtjes nuk eshte bere ndarja e kerkimeve, por heqje dore nga gjykimi i ceshtjes, jo ne formen e kerkuar nga ligji. Vendimi i gjyqtares per vecim ceshtje eshte absolutisht i pavlefshem. Gjyqtarja e kalon ceshtjen ne sekretari me shkresen nr.36 akt; date 02.03.2011. Dhe per kete suate me date 09.03.2011 ka njoftuar Kryeinspektoren e KLD, Valbona Vata. Ne periudhen 02.03.2011 deri me 05.07.2011 ceshtja ka qendruar ne sekretari te gjykates pa asnje lloj veprimi. Shorti i hedhur me date 05.07.2011 i ka kaluar kete ceshtje perseri gjyqtares Herila Cela dhe ne seancen pergatitore ankuesja Dodona Ramadani ka paraqitur kerkese per perjashtim gjyqtari. kerkese e cila eshte miratuar nga gjyqtarja dhe kryetari i gjykates ne date 15.09.2011. Ceshtja pas shortit i kalon gjyqtares Marinela Nuni, e cila pas mbajtjes se saj 1 muaj e 14 dite, me vendim te KLD te dates 14.11.2011 eshte transferuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane. Me date 17.11.2011 ceshtja e vecuar i ka kaluar me short gjyqtarit Arqile Basha, i cili pas 5 muaj e 6 dite me date 23.04.2012 ka marre vendimin nr.1211, "Pranimin e padise", vendim i cili ka marre forme te prere.

Sa me siper eshte konkluduar se nga ana e gjyqtares Herila Cela eshte konstatuar zvarritje e pajustificuar dhe e perseritur e veprimeve procedurale, te kryera gjate ushtrimit te funksionit prej saj, te cilat mund te sjellin pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve. Ky konkluzion bazohet ne argumentet e meposhtem:

a) Gjykimi i ceshtjes ka zgjatur per nje periudhe prej 1 vit e 3 muaj (prej 7 muaj e 18 dite nga gjyqtarja Herila Cela) ne shkelje te dukshme te afatit te caktuar nga vendimi i KLD-se Mbi krteret matese te veprimtarise gjyqesore:

b) Gjyqtarja Herila Cela ka gabuar ne vendimin e ndermjetem te dates 17.11.2010, me te cilin ka vendosur: "Veçimin e ceshtjes civile nr. 3993, date 28.12.2009, Dergimin e dosjes gjyqesore ne kryesekretarine e gjykates per kryerjen e veprimeve duke e rihedhur ne short pjesen e veçuar te padise se paditeses ". Ajo ka vendosur ne kundershtrim me nenin 159 te K.Pr.Civile per vecimin e ceshtjes. Lidhur me kete vendim edhe Gjykata e Apelit Vlore "...cmon se vendimi per vecimin e ceshtjes nga Gjykata e Shkalles se Pare eshte jo vetem ne kundershtrim me detyrat

e lena nga Gjykata e Apelit por aq kontradiktore dhe ne mungese te plote te bazueshmerise ne ligjin procedural, gjykata do te duhet te gjykonte ceshtjen se bashku dhe jo vecmas”.

Sa me siper eshte konkluduar se nga ana e gjyqtares Herila Cela eshte konstatuar zvarritje e procesit gjyqesor duke konstatuar se ceshtja ka zgjatur tej afateve proceduriale e konkretisht 1 vit 9 muaj dhe 5 dite, nga 23 seancat e zhvilluara 4 jane shtyre mbi 1(nje ) muaj e gjysme duke konkluduar se sa me siper perben shtyrje te pajustificuar te seancave gjyqesore me pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve ndergjyqese ne proces. Per kete ceshtje i eshte paraqitur relacion Ministrit te Drejtesise me shkresen 262/1 prot date 20.3.2013.

Te gjitha relacionet e mesiperme jane bashkuar ne nje te vetem dhe ne baze te nenit 16, (1) pika e) e ligjit nr. 8811 date 17.05.2001 “Per Organizimin dhe Funkcionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise” i ndryshuar, dhe nenit 33 (1) pika b) te Rregullores “Per Organizimin dhe Funkcionimin e Inspektoriatit te Keshillit te Larte te Drejtesise” ne materialin e derguar eshte sugjeruar dergimi materialit te kontrollit qe i perket ankesave te qytetareve Kico Billa, Myzejen Zyka, Odeta Haxhi, Dodona Ramadani per vleresimin e mundesise se fillimit te procedimit disiplinor per gjyqtaren Herila Cela, nga zevendes kryetari i KLD me shkresat nr. prot. 697, date 05.03.013, 262/1 date 20.3.2013, 262/3 date 30.4.2013 dhe nr. prot 2372 date 26.08.2013.

Ne vijim, Ministri i Drejtesise me shkresen 949 date 6.2.2014 ka komunikuar kerkesen mbi fillimin e procedimit disiplinor te gjyqtares Herila Cela duke propozuar marrjen e mases disiplinore dergimi per 1 deri ne 2 vite ne nje gjykate te te njejtit nivel jashte rrethit gjyqesor ku gjyqtarja ka emerimin.

Shqyrtimi i kerkeses se Ministrit te Drejtesise per procedimin disiplinor ndaj paditeses Herila Cela eshte bere pjese e rendit te dites ne mbledhjen e dates 21.07.2014 te Keshillit te Larte te Drejtesise. Gjate zhvillimit te kesaj mbledhjeje Ministri i Drejtesise ka ndryshuar kerkesen per mases disiplinore ndaj paditeses, nga masa “deregimi per 1 deri ne 2 vite ne nje gjykate te te njejtit nivel jashte rrethit gjyqesor ku gjyqtarja ka emerimin” ne mases “Verejtje me paralajmerim”. Pas shqyrtimit te kerkeses se Ministrit te Drejtesise, Keshilli i Larte i Drejtesise me vendimin Nr. 105 date 21.07.2014 ka vendosur “Pranimin e kerkeses se Ministrit te Drejtesise per dhenien e mases disiplinore ndaj gjyqtares se Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore,

Herila Cela. Dhenien e mases Disiplinore "Vercjtje me paralajmerim" ndaj gjyqtares se Gjykares se Rrethit Gjyqesor Vlore, Herila Cela."

Pala e paditur, Keshilli i Larte i Drejtesise, ka arritur ne konkluzionin se:  
- shkeljet e konstatuara ne veprimtarine gjyqesore te gjyqtares vleresohen se kanë shkaktuar shqetesim ne një mase te madhe te njerzve te interesuar, duke demtuar besimin e publikut tek dhënia e administrimi i drejtesise, duke ulur imazhin e sistemit gjyqesor, duke prekur interesat e një mase te madhe njerzish (vendime te zvarritura pertej afateve te arsyeshme. Këto kanë shkaktuar dëme per palët, kanë cënuar te drejtat e tyre kushtetuese).

- Sjellja e gjyqtares ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e saj, dhe ka treguar paafësinë e saj per te përballuar punën e tij te përditshme.

Këto veprime te gjyqtares përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen ne kuptim te nenit 32/1/b si dhe nenit 32/3/a te Ligjit nr.9877/2008 "Per organizimin e pushtetit gjyqesor ne Republikën e Shqipërisë". Ne faktet që i atribuohen gjyqtares plotësohen te gjitha kushtet e këtij parashikimi ligjor:

i. shkelja e pajustificuar te dispozitave urdhëruese procedurale:

ii. shkelja e përsëritur te dispozitave urdhëruese procedurale dhe:

iii. ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave per te drejtat kushtetuese te palëve ne gjykim apo per dhënien e drejtesise.

KLD, bazuar ne nenet 33 pika 2 germa "b" te ligjit Nr. 9877/2008 "Per organizimin e pushtetit gjyqesor ne Republikën e Shqipërisë" ne nenin 33 te ligjit Nr. 8811/2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise" i ndryshuar, si dhe ne rregulloren "Per procedimin disiplinor te gjyqtareve", ka vleresuar te drejte kerkesen e Ministris te Drejtesise per

procedimin disiplinor te gjyqtares Herila Cela dhe dhenien e mases disiplinore "Verejtje me paralajmerim" ndaj saj.

**Duke mos qene dakort me vendimin, paditesja Herila Cela i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Apelit me padi duke kerkuar shfuqizimin e tij me pretendimin se:**

- jam gjyqtare me eksperience te gjate ne pune, me vleresime ne vijimsi shume te mira dhe me vleresime te larta nga ana e Keshillit te Larte te Drejtesise.
- Materiali i procedimit disiplinor ndaj meje ka filluar mbi bazen e 4 ankesave te 4 paleve ndergjyqese ne ceshtje te shqyrtura prej meje ne nje peridhe disa vjecare. Nga keto 4 ankesa, njera ajo e Myzejen Feratit nuk eshte nje ankese kunder meje, por nje ankese kunder sistemit te drejtesise ne pergjithesi dhe ligjeve te vendit qe nuk ndalojne palen e saj kundershatare per te bere padi kunder saj. Ne ketu kushte, per kete ankese nuk duhet te kishte nisur fare procesi i verifikimit dhe aq me pak perfshirja e rastit ne materialin procedues;
- ne shkelje te nenit 16/1 a dhe b te ligjit nr. 8811, date 17.05.2001, Per organizimin dhe Funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise, dhe rregullores per 2 nga 4 rastet, e konkretisht per rastin e shtetases Dodona Ramadani dhe Myzejen Ferati nuk kam pasur dijeni se eshte bere ndonje verifikim ne dosjet e mia gjyqesore dhe as me eshte dhene materiali nga ana e inspektoreve ose nga ana e kryetarit te gjykates. Per here te pare, ne lidhje me ankesat, kryerjen e verifikimeve dhe permbajtes se materialit verifikues jam vene ne dijeni ne momenin ne te cilin me ka njoftuar materialin procedues, Ministri i Drejtesise:
- procesi administrativ ne teresi nuk ka qene nje proces efektiv pasi ne materialin e derguar KLD per vleresim ne mbledhjen ne te cilen eshte marre masa ne shqyrtim nuk rezulton te jene te cituara argumentat e dhena prej meje por eshte mjaftuar vetem me shprehjen argumentat e gjyqtares nuk qendrojne pa i permendur ato ne asnje rast;
- nga procesverbali i diskutimeve te bera ne mbledhje nuk rezulton te kete pasur nje diskutim real ne lidhje me rastin konkret, por diskutimet jane orientuar ne tema qe nuk lidheshin me rendin e dites dhe faktin apo shkeljen qe po shqyrtohej;
- masa e propozuar eshte nje mase e cila parashikohet per shkelje te lehta te ligjit, dhe duke qene se ligji nga menyra si eshte konceptuar parashikon masa te lehta per shkeljet e lehta, asnje prej veprimeve apo mosveprimeve apo shkeljeve qe me atribuohen nuk u pretendua qe te ekzistonte

ndaj nuk ka si te denohem me nje mase pa percaktuar qarte shkeljen e lehte per te cilen jam proceduar;

- Vendimi nr. 199 i KLD nuk eshte nje vendim i cili te percakton afate te detyrueshme per shqyrtimin e ceshtjeve gjyqesore. Ky vendim percakton disa kriteret dhe afate orientuese, jo detyrues, por qe ne teresine e tyre evidentojne punen ne teresi te gjyqtareve e duhen marre ne teresi te tere keta kriteret. Ne kete periudhe kam pasur nje ngarkese shume te larte ne pune me nje numer shume te larte ceshtjesh qe e tejkalon teper kriterin sasior te percaktuar ne te njejtin Vendim te Keshillit te Larte te Drejtesise.

- shkeljet nuk jane te tilla qe te justifikojne nisjen e procedimit per mase disiplinore dhe nuk jane ne perputhje me vendimet unifikuese te gjykates se larte qe kane percaktuar vleresimin e ketyre kriterëve apo kriterëve te ngjashme ne punen e gjyqtareve;

Me tej gjyqtarja ka argumentuar rast pas rasti edhe qendrimi e saj ne lidhje me secilin prej gjetjeve te bera nga ana e Keshillit te Larte te Drejtesise per secilin prej rasteve duke konsideruar se shkeljet nuk qendrojne. Ne menyre te permbledhur per secilin rast ajo ka parashtruar se:

- Rasti Kico Billa ceshtja ka zgjatur vetem 6 muaj e 22 dite, pra ne nje afat thuajse te afert me ate te percaktuar ne vendimin e KLD. Kthimi i padise me te meta, eshte bere pasi paditesi ishte ne dijeni te faktit qe personat e trete kishin vdekur jo gjate gjykimit, por shume kohe para se te ngrihej padia, e konkretisht njeri prej 34 vitesh dhe tjetri prej 8 vitesh. Lenia e afatit 7 ditor nuk eshte nje afat i paarsyeshem, se pari pasi palet vete ishin dakort me kete afat (mjafte te shikohet procesverbali i seances) dhe se dyti pasi personat e trete kishin vdekur shume kohe para se ngrihej padia duke qene leshuar edhe me pare deshmite e trashegimise per ta. Qe nga data e marrjes se vendimit te apelit e deri ne daten ne te cilen u kerkuan deshmite kishte kaluar nje periudhe shume e gjate kohe e per me teper, edhe ne gjykimin e kryer prej meje kishte 6 muaj qe ata paditesit e dinin qe duheshin zbatuar detyra e lena nga Gjykata e Apelit ne lidhje me thirrjen e personave te trete e roli i tyre ne gjykim duhet te jete nje rol aktiv e jo pasiv, duke ndihmuar procesin e jo duke mos e ndihmuar ate. Shtyrjet e seancave kane qene te tera te bera per shkaqe te perligjura dhe per mungese te komunikimeve te paleve ndergjyqese. Nderkohe ngarkesa e perballuar nga une ne ate kohe ka qene e tille qe e ka bere te pamundur lenien e seancave ne nje afat me te shkurter kohor. Ne vitin 2011 kam gjykuar 671 ceshtje gjyqesore, kur ngarkesa mesatare ne vit per cdo gjyqtar eshte 262 ceshtje dhe nderkohe kjo ngarkese eshte shume me e

larte se numri i ceshtjeve qe duhet te shqyrtohen sipas kriterit sasior te vendosur nga ana e Keshillit te Larte te Drejtesise ne vendimin e tyre.

- Rasti Myzejen Ferati, eshte nje rast per te cilin nuk duhej te nisej procedimi pasi ne ankesen e paraqitur prej saj, nuk ka ndonje fakt apo rrethane konkrete per te cilin te pretendohet se veprimtaria ime si gjyqtare te mos kete qene ne perputhje me ligjin.

Ne edo rast edhe per afatin e ketij gjykimi eshte e rendesishme te theksoj se seancat gjyqesore jane shtyre me kerkese te paleve per shkaqe te justifikuara dhe nuk ka pasur ne asnje rast shtyrje per shkaqe te pajustificuara ne kuptim te Kodit te Procedures Civile. Caktimi i seancave ne ndonje rast ka qene per shkak te volumit te punes dhe nr shume te madh te ceshtjeve ne shqyrtim qe e ben te pamundur menaxhimin ne nje kohe me te shkurter te seancave gjyqesore. Ky fakt duhet te ishte marre ne konsiderate nga ana e inspektoreve te KLD ne konkludimin e gjetjeve te inspektimit dhe propozimeve perkatese.

-Rasti Dodona Ramadani, eshte nje tjeter rast ne te cilin KLD pretendon se ka pasur zvarritje te procesit, por ne fakt edo seance eshte shtyre vetem per shkaqe te perfigjura dhe afati i shqyrtimit te ceshtjes ka qene brenda afatit te konsideruar prej tyre si nje afat i arsyeshem. Vecimi i ceshtjes eshte bere me kerkese te te dy paleve dhe perputhje me parashikimet e Kodit te Procedures Civile pasi jane palet ata qe percaktojne se cili eshte objekti i kerkimit te tyre dhe nese ceshtja do te mund te zgjidhet brenda nje gjykimi apo jo. Gjykata mund te vecoje ceshtjet edhe per shkak te kompleksitet te tyre. Ne edo rast, veprimi vecimit nuk eshte nje prej te cilit te kete ardhur zvarritje ne proces, duke qene se pjesa e vecuar e cila ishte ne kompetencen time per ta shqyrtuar eshte kryer ne afate te pershtatshme kohore. Ceshtje e vecuar, eshte zgjatur ne shqyrtimin e ceshtjes pasi gjyqtari te cilit i vajti ceshtja e gjykuar vendosi te mos e gjykonte ceshtjen dhe te konstatonte te pavlefshem vendimin tim, ne nje kohe qe nuk ka kompetence per shqyrtimin e ketyre ceshtjeve nje gjyqtar i po te njejtes shkalle gjykimi. Fakti qe dosja e vecuar nuk eshte gjykuar apo eshte lene ne sekretari pa veprime nga kryesekretarja nuk eshte nje fakt qe mund te me atribuohet mua si shkelje. Eshte e vertete qe gjykata e apelit e ka prishur me pas ceshtjen e shqyrtuar prej meje dhe ka konsideruar te gabuar vendimin tim duke e prishur dhe kthyer ceshtjen per rigjykim per here te dyte, por nje fakt i tille ne asnje rast nuk te con ne nisjen e nje

procedimi disiplinor per faktin se si ne gjykim dhe ne rigjykim jane palet ata qe vendosin ne lidhje me objektin e kerkimit dhe nder te tjera jo cdo shkelje proceduriale mund te jete shkak per procedim disiplinor. Nder te tjera vete fakti qe Gjykata e Apelit e ka kthyer ceshtjen e shqyrtuar prej meje per here te dyte ne gjykate te shkalles pare per rigjykim eshte nje veprim haptaz ne kundërshtim me kodin e procedures civile. pasi gjykata e apelit duhet ta kishte gjykuar ceshtjen vete. (me hollësisht ne pretendimet e paleve ne dosjen gjyqesore)

**Lidhur me shkaqet e cituara me siper, perfaqesuesi i pales se paditur, KLD, kërkoj rrëzimin e padisë duke prapësuar se:**

-Procedura administrative e ndjekur per identifikimin e pergjegjesise disiplinore te gjyqtares Herila Cela eshte ne perputhje me ligjin dhe eshte zbatuar rregullisht e drejta e saj per tu mbrojtur nuk ka te meta apo vese ne asnje hallke te saj. Kjo procedure ka ndjekur rigorozisht rregullat e percaktuara ne ligj dhe ka garantuar te drejten e saj per nje proces te rregullt disiplinor. Asaj i eshte dhene mundesia per t'u njohur me materiet e procedimit dhe per te shprehur argumentat e saj mbrojtës me shkrim e me goje. kjo i ben te pabaza pretendimet per nje procedure te parregullt gjate procedures se procedimit disiplinor: inspektorët e KLD ia kane dorezuar materialin Kryetarit te Gjykates. e drejte kjo qe ia njeh ligji.

-Pretendimi se masa me e lehte nuk eshte masa e duhur. prapsoi se masa e dhene ploteson kriteret e njohura ne vijimesi nga doktrina kushtetuese, e konkretisht. shkelja per te cilen eshte proceduar gjyqtarja eshte nje shkelje e percaktuar shprehimisht ne ligj; sanksioni qe mund ti jepet gjyqtares eshte i percaktuar shprehimisht ne ligj, organi procedues nuk i ka dhene nje mase me te rende, por nje mase me te lehte.

- Kriteret e vendosura nga KLD ne vendimin nr 199. jane kritere te studiuara mire dhe te vleresuara apo lidhura me shume aspekte, cka eshte marre ne konsiderate ne hartimin e vendimit. KLD i vlereson rast pas rasti ceshtjet nga kompleksiteti i tyre por nga ana tjetër eshte shume i rendesishem dhe e drejta e qytetareve per te marre drejtesi brenda nje afati te arsyeshem i parashikuar nga kushtetuta ne nenin 42 dhe Konventa evropiane e te drejtave te njeriut ne nenin 6

pika 1. Gjyqtaret kane detyrimin per te siguruar nje gjykim te shpejte sic e kerkon neni 42 i Kushtetutes dhe neni 6 /1 i KEDNJ.

**Ne analize te pretendimeve te parashtruara nga pala paditese, prapesimeve te pales se paditur, dhe provave te administruara ne gjykim Gjykata Administrative e Apelit vlereson se:**

**Se pari**, kjo Gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e ceshtjes objekt shqyrtimi. Lidhur me kompetencen lendore neni 7 i ligjit Nr. 49/2012 percakton se “Gjykatat administrative jane kompetente per: a) mosmarrveshjet qe lindin nga aktet administrative individuale, aktet nenligjore normative dhe kontratat administrative publike, te nxjerra gjate ushtrimit te veprimtarise administrative nga organi publik” Kurse neni 17 i po ketij ligji parashikon rrethin e mosmarrveshjeve lidhur me aktet administrative qe shqyrtohen nga gjykata administrative. Ne piken 1 germa “a” te kesaj dispozite parashikohet se “1. Padia ngrihet: a) per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ:”

Lidhur me kompetencen funksionale, ne nenin 10 pika 2 germa “b” te ligjit Nr. 49/2012 eshte percaktuar kompetenca e Gjykates Administrative te Apelit per gjykimin ne shkalle te pare te mosmarrveshjeve ne rastet te parashikuara ne ligj. Ne nenin 36 pika 2 te ligjit Nr. 9877/2008 “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise” eshte percaktuar se ankimi kunder masave disiplinore, pervec mases disiplinore “shkarkim nga detyra” behet ne Gjykatën e Apelit Tirane. Por duke qene se mosmarrveshja i perket lendes administrative, kompetenca funksionale per gjykimin e ceshtjes ne shqyrtim i perket Gjykates Administrative te Apelit.

**Se dyti**, Gjykata ne referim te kriterëve te nenit 15 te ligjit Nr. 49/2012 mori ne shqyrtim legjitimitetin aktiv te pales paditese. Qe te justifikohet ligjerisht kerkimi per njohjen ose rivendosjen e nje te drejte te shkelur ose te mohuar, ky kerkim duhet te behet vetem prej atij te cilit sipas ligjit i perket e drejta e mohuar ose e shkelur prej nje te treti dhe vetem kunder atij qe me faktin ose me vepren e tij mohon ose shkel te drejten e kerkuesit duke justifikuar ne kete menyre nderhyrjen e gjykates. Lidhur me kete fakt, dispozita e siperpermendur parashikon se: “Te drejten e ngritjes se padise e ka: a) çdo subjekt, qe pretendon se i është cenuar një e drejtë



apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;” Përsa vendimi Nr. 46 i palës se paditur krijon pasoja juridike për paditësen pasi masa disiplinore që përmban ky vendim është dhënë ndaj saj, paditësja ka legjitimitetin aktiv në ngritjen e kësaj padie.

Se treti, në shqyrtimin e ligjshmerisë së vendimit Nr. 105 datë 21.07.2014 të palës së paditur. Gjykata mban në konsideratë parashikimet e nenit 37 të Ligjit Nr. 49/2012 sipas të cilit:

“1. Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

2. Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkojnë nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

- a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;
- b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;
- c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.”

Duke vlerësuar në përputhje me kriteret e mesipërme aktin e kundërshtuar nga pala paditëse, ky kolegji, fillimisht evidenton se janë plotësisht të provuara dhe të pakontestuar nga palët rrethanat faktike mbi të cilat është marrë vendimi nga pala e paditur lidhur me paditësen Herila Cela, rrethana këto që janë përshkruar me siper në këtë vendim. Pretendimi i paraqitur nga pala paditëse lidhet pikërisht me analizën e këtyre rrethanave të faktit.

Në ligjin Nr. 9877/2008 rezulton të jete parashikuar hollesisht përgjegjësia për shkeljet disiplinore për gjyqtarët, masat disiplinore dhe procedimi disiplinor i tyre.

Në nenin 31 të këtij ligji është parashikuar se: “1. Gjyqtari i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet dhe me garancitë e parashikuara në ligj. 2. Gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.”

Ne nenin 32 jane parashikuar shkeljet e disiplinës së gjyqtarit te cilat ndahen në: a) shumë të rënda; b) të rënda; c) të lehta.

Në pikën tre të kësaj dispozite janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

*a) zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë:*

Ne analize te ketyre dispozitave rezulton se prej paditeses nuk janë kryer shkelje të rënda te disiplinës qe sipas percaktimeve te ligjit Nr. 9877, diskrediton rende pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Ne keto rrethana pala e paditur nuk ka vleresuar drejtë veprimtarinë e punës së paditeses për rastet në procedim që për pasojë të passjellin pergjegjesinë disiplinore të saj në bazë të neneve 32/1/b, 32/3/a dhe 33/2/b.

Neni 33 i ligjit parashikon

*Masat disiplinore*

*1. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.*

*2. Masat disiplinore janë:*

*a) vërejtje;*

*b) vërejtje me paralajmërim;*

*c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët;*

*ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij;*

*d) shkarkim nga detyra.*

3. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 2 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni.

4. Për shkeljet e rënda, të parashikuara në nenin 32 pika 3 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "e" dhe "ç" të pikës 2 të këtij neni.

5. Për shkeljet e lehta, të parashikuara në nenin 32 pika 4 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni.

6. Për efekt të procedimit disiplinor, masat disiplinore të rënda shlyhen brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, ndërsa masat disiplinore të lehta shlyhen brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Pra vetë ligji ka percaktuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit se masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer dhe duke patur parasysh këtë parim ka percaktuar konkretisht edhe masën disiplinore perkatese për çdo kategori shkeljesh. Konstatohet se për shkeljet e rënda, në të cilat është përfshirë edhe shkelja e parashikuar nga germa "a" e pikës 3 të nenit 32, janë percaktuar si masa disiplinore :

c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët;

c) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij;

Në rastin konkret ndaj paditëses duke qenë se ajo është gjyqtare në shkallë të parë është propozuar masa disiplinore dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij.

Pavaresisht kësaj, pala e paditur ka dhënë ndaj paditëses masën disiplinore "Verejtje me paralajmërim" e parashikuar si e tillë në germen "b" të pikës 2 të nenit 33 dhe që sipas percaktimeve të pikës 5 të këtij neni jepet për kategorinë e shkeljeve të lehta.

Kolegji administrativ vlerëson se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit sipas parashikimit të nenit 147 pika 4 e Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin që rrjedh nga Kushtetuta të vendosë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve sipas ligjit. Kjo do të thotë që është ky organ kushtetues që evidenton shkeljen disiplinore dhe cakton në përputhje me këtë shkelje masën përkatëse disiplinore.

Ky përcaktim gjën pasqyrim edhe në nenin 2 germa “ç” të ligjit Nr. 8811/2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe në pikën 1 të nenit 33 të ligjit Nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”.

Por vendimarrja e KLD lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve bëhet mbi bazën e një procedure të caktuar të parashikuar në ligj. Lidhur me këtë procedure midis të tjerave në ligjin Nr. 8811/2011, në nenin 31 të tij, në pikat 3 e 4 është parashikuar se:

*“3. Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, **Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.***

*4. **Kërkesa për procedimin disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht.***”

Kurse në nenin 33 pika 3 të ligjit në fjale është parashikuar se:

*“Rregullimi i hollësishëm i shqyrtimit të procedimit disiplinor caktohet në rregulloren përkatëse të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”*

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar me vendimin Nr. 137 datë 21.02.2003, Rregulloren “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”. në këtë rregullore është parashikuar:

#### Neni 1

1. Procedimi disiplinor për gjyqtarët vihet në lëvizje nga Ministri i Drejtësisë.

#### Neni 2

- 1) Kërkesa për procedim disiplinor për gjyqtarët depozitohet nga Ministri i Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- 2) Në kërkesën për procedim disiplinor të përcaktohen shkeljet e ligjit që përbëjnë shkeljedisiplinore, si dhe lloji i masës që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit që procedohet.

#### Neni 9

2. Pas diskutimit përfundimtar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kalon në votimin e masës disiplinore të propozuar nga Ministri i Drejtësisë.

#### Neni 11

2. Ministri ka të drejtë të disponojë për kërkesën e bërë prej tij në çdo kohë deri në momentin kur ka filluar votimi.

Ne analize të dispozitave të sipercituara, nenit 31 pikat 3 e 4 të ligjit Nr. 8811/2001 dhe rregullores së dale në zbatim të tij, konstatohet se ligjvënensi i ka dhënë Ministrisë të Drejtësisë të drejtën e inicimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtareve duke i dhënë njëherësh të drejtën të disponojë propozimin edhe për llojin e masës disiplinore lidhur me shkeljet e konstatuara. Në çdo rast Këshilli i Lartë i Drejtësisë shtron për diskutim dhe votim në shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtareve, shkeljet disiplinore të evidentuara në kërkesën e paraqitur nga Ministri dhe masën perkatese të propozuar në këtë kërkesë. Është pikërisht kjo mënyra e disponimit që i ka njohur ligji paletë së paditur në këtë proces.

Edhe në rastin e paditeses Herila Cela, Ministri i Drejtësisë konstatohet të ketë ushtruar pikërisht këtë të drejtë që i ka dhënë ligji lidhur me disponimin për masën disiplinore. Fillimisht prej tij është propozuar masa disiplinore *“dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”* e gjatë shqyrtimit të procedimit, ka

ndryshuar propozimin duke kerkuar ndaj paditeses masen "Verejtje me paralajmerim", mase e cila edhe eshte votuar nga anetaret e Keshillit te Larte te Drejtesise.

Pra lidhur me aspektin procedural te dhenies se kesaj mase disiplinore ne lidhje me mungesen e shkeljes se lehte per te cilen duhet te konsiderohet kjo mase ndaj paditeses nuk konstatohet asnje shkelje e parashikimeve ligjore.

Kolegji administrativ ne analize te sa me sipër konkludon se veprimtaria e pales se paditur me nxjerrjen e vendimit Nr. 105 date 21.07.2014 është marrë në kundërshtim me faktet dhe provat objekt i procedimit disiplinor pasi nga veprimtaria e gjyqtares nuk konstatohen dhe nuk u provuan ezksitencia e akteve të renda dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit nëpërmjet zvarritjes së pajustificuar dhe të përsëritur të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë pasi :

Ne lidhje me pretendimi se per ceshtjen e Myzejen Feratit Keshilli i Larte i drejtesise nuk do te niste procedimin pasi nuk kishte ankese ndaj gjyqtares. gjykata ndonese e konsideron te drejte faktin se keto lloj inspektimesh kryhen vetem mbi bazen e ankeses se verifikuar nga ana e inspektoriatit te keshillit te larte te drejtesise nuk e konsideron ate si nje fakt apo rrethane e do te conte ne mungesen e procedimit. Kjo pasi nuk ka nje numer te caktuar kumulativ ceshtjesh ne menyre qe te nise procedimi disiplinor. ky procedim mund te nise edhe per nje shkelje te vetme apo per nje rast te vetem. Ne keto kushte e konsideron te parendesishem per ceshtjen ne teresi kete pretendim.

Në lidhje me pretendimin e mungeses se nje procesi te rregullt ligjor ne procedimin administrativ ne te cilin ti jepej pales e drejta e njohjes me inspektimin dhe nisjen e procedures, gjykata gjen me vend te theksoje se ndersa eshte i drejte pretendimi i paditeses se gjyqtari duhet te njoftohet si per nisjen e verifikimit ashtu edhe per materialin. pasi kjo shkelje procedurale nuk eshte e tille sa te beje teresisht nul procedimin administrativ apo te kete mohuar te drejten e pales per t'u mbrojtur ne kete proces.

Gjykata Kushtetuese ne vendimin e saj nr 6 /2009 shprehet se : *"E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk ka karakter thjesht procedural dhe aq më tepër nuk mund të trajtohet si e tillë*

*kur bëhet fjalë për procedura që ndërmerren ndaj një gjyqtari/eje. Kjo për faktin se, gjyqtari/rja ka një rol të veçantë në demokraci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut dhe gëzon një status të privilegjuar, siç përcaktojnë parimet themelore të Kartës Evropiane që përbëjnë Statutin për gjyqtarët në një shtet ligjor dhe të së drejtës. Në këto kushte, e drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore kushtetuese..... nuk do të kishte kuptim në rast se ajo nuk do të kishte një mbrojtje efektive”.*

E drejta për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, e garantuar në nivelin e të drejtave të njeriut, (neni 6 i KEDNJ), dhe e sanksionuar në Republikën e Shqipërisë si një prej të drejtave themelore kushtetuese, përbën në të njëjtën kohë një prej parimeve bazë më të rëndësishme, e detyrueshme për t'u respektuar si nga gjykatat gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore ashtu dhe nga të gjitha institucionet shtetërore përgjegjëse gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, sic është rasti i procedimit disiplinor të gjyqtarëve.

Ne çdo rast, në çështjen në shqyrtim nuk rezulton që paditeses ti jete mohuar kjo e drejte apo te mos kete pasur mundesine e mbrojtjes. Rezulton e provuar se paditesja ka pasur te drejten e mbrojtjes ne procesin administrativ dhe i jane vene ne dispozicion materialet perkatese nga ana e Ministririt te Drejtesise, dhe i eshte dhene mundesia per tu degjuar ne Keshillin e Larte te Drejtesise duke u mbrojtur edhe me avokat, cfare e ploteson ne thelb te drejten e saj per nje proces te rregullt ligjor dhe te drejten per tu degjuar e mbrojtur nga akuzat. Gjithashtu gjykata konstaton se kjo shkelje procedurale ne proceduren administrative nuk eshte e tille qe te coje ne pavlefshmerine e tere procesit dhe se vendimarrja do te kishte qene e njejta edhe ne rast se do te ishte njoftuar gjyqtarja rregullsisht per kryerjen e inspektimit.

Ajo qe gjykata mendon se eshte argumenti me i rendesishem ne lidhje me kete ceshtje dhe ne te cilin duhet te ndalet per ta argumentuar me gjate eshte nese perben apo jo shkelje procedurale zgjatja e afatit te gjykimeve tej afatit te percaktuar ne vendimin nr. 199 te Keshillit te Larte te Drejtesise dhe nese po, a eshte kjo shkelje apo shkelje te ngjashme procedurale te tilla qe te justifikojne nisjen e nje procedimi dhe marrjen e nje mase disiplinore

Me vendimin Nr.105, datë 21.07.2014 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: “Vërejtje me paralajmërim” për shkarkimin nga detyra të gjyqtares, për sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtares, si dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.”

Me vendimin Nr.105, datë 21.07.2014 Këshilli i Lartë i Drejtësisë arsyeton: “*Këto veprime të gjyqtares H.Ç., përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen në kuptim të nenit 32/1/b si dhe nenit 32/3/a të Ligjit nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Në faktet që i atribuohen gjyqtares H.Ç., plotësohen të gjitha kushtet e këtij parashikimi ligjor:*

- i. shkelja e pajustificuar të dispozitave urdhëruese procedurale;*
- ii. shkelja e përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale dhe;*
- iii. ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë”.*

Ne fakt asnjë prej rasteve nuk perben shkelje te pajustificuar apo te perseritura te dispozitave proceduriale. Nuk eshte vertetuar as ardhja e pasojave per te drejtat kushtetuese te individeve per shkak te shkeljeve te pajustificuara apo te perseritura te ketyre normave. Gjykata konstaton se vendimi i Keshillit te Larte te Drejtesise “Mbi kriteret matese te Veprimtarise se Gjyqtarit” nuk eshte nje vendim qe perreakton afate te detyrueshme per kohezgjatjen e proceseve gjyqesore.

Ne fakt, ky vendim, ne nenin I te tij parashikon se: efektiviteti i i gjyqtari perfitohet dhe nga vleresimi i permbushjes se **standarteve orientuese** ne aspektin sasior, cilesor dhe kohor te veprimtarise se gjyqtareve, standarte te cilat jane te rivleresueshme. Vendimi cileson se **standartet jane orientuese dhe jo te detyrueshme**. Secili prej gjyqtareve duhet te beje me te miren e arsyeshme per te garantuar keto standarte, por ne cdo rast ato duhet te merren e te konsiderohen ne teresine e tyre dhe per qellimin per te cilat jane vene si te tille. Afatet procedurale nuk percaktohen me vendim te Keshillit te Lartet e Drejtesise, por me ligj e ne kodet e procedures.



Kolegji Administrativ i Apelit ne vleresim teresor te te tera provave te paraqitura ne gjykim konsideron se nuk ka pasur zvaritje te procesit gjyqesor te ardhur per shkak te paafetise ose organizimit te keq te punes se gjyqtares por se ato kane qene per shkak te ngarkeses se madhe qe ajo ka pasur ne vitet 2011 – 2012 konkretisht kur ka shqyrtuar perkatesisht 671 dhe 721 ceshtje. Ky numer eshte gati 5 here me i madh se numri i ceshtjeve qe duhet te shqyrtoje ne vit nje gjyqtar e ne parim, pra edhe afatet ne gjykim nuk mund te mos cenohen nga nje numer kaq i madh dosjesh ne shqyrtim. Gjithsesi ajo qe Kolegji Administrativ i Apelit konstaton eshte se mospermbyllja e nje ceshtjeje gjyqesore brenda afati 6 mujor nuk perben ne menyre automatike shkelje te dispozitave procedurale qe te çojne ne nisjen e nje procedimi disiplinor dhe per me teper te rezultojne me marrjen e mases disiplinore.

Në vendimin Nr.17, datë 12.11.2004, Gjykata Kushtetuese, duke krijuar jurisprudencë të qartë dhe përfundimtare, arsyeton se:

“Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra të gjyqtarit mënyrën e gabuar të zbatimit të dispozitave materiale e procedurale për çështje konkrete në gjykim, jo vetëm ushtron attribute që nuk i përkasin, por ndërhyt drejtpërsëdrejti në objektivitetin dhe pavarësinë e gjykatës.”

Gjykata Kushtetuese thekson se: gjyqtari nuk mund të jetë objekt i procedimit disiplinor, për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij, mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta.

Gjykata e Lartë me vendimin Nr.7, datë 07.03.2006, rikonfirmon qëndrimin e shndërruar në jurisprudencë kushtetuese përfundimtare, ndersa argumenton pabazueshmërinë në ligj të një vendimi të KLD: “Inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë, pavarësisht hierarkisë së tyre, nuk kanë të drejtë të interpretojnë vendimet gjyqësore në mënyrë negative, për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin ....Këto vendime, qoftë dhe të formës së prerë, mund të jenë shkak për shkarkim nga detyra vetëm në se shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.”

Ne referencë të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.1/2013: “Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vazhdim të analizës së mësipërme vlerësojnë të theksojnë dhe njëherë se **jo në çdo rast mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart e con gjyqtarin përpara procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar në humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.”**

Pala e paditur nuk arriti të provojë në këtë gjykim se rastet objekt i padisë të kene plotësuar këto kushte dhe këto kritere të percaktuara nga vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. pasi nuk u provua që paditesja të kete kryer veprime të tilla që të kene rezultuar në një neglizhencë të apo mungesë kujdesi apo operativiteti të kufirit të të arsyeshmes që të çojne në cënimin e prestigjit të gjyqtarit apo humbjen e besimit ndaj tij.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.7/2006, shprehën se:

*“Në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë si shkelje që konsistojnë në veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe që sipas tij në vetvete përbëjnë akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, përmenden 10 vendime gjyqësore me shkelje të ligjit material apo procedural të nxjerra nga periudha e kontrolluar 2001 - 2004.*

*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i interpretojë vendimet gjyqësore në mënyrë negative, për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin që ka qenë në përbërje të trupit gjykues. Këto vendime qoftë dhe të formës së prerë, mund të jenë shkak për shkarkim nga detyra vetëm në se shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.*

## **Gjykata e Larte ne vendimin e sipercituar ka orientuar edhe se:**

*Procesi gjyqësor ne vetvete mund te ndahet në dy segmente kohore: (1) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimet procedurale që duhet të ndërmerren palët në proces, dhe (2) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjyqtarit, duke zbritur nga e gjithë kohëzgjatja reale e procesit gjyqësor afatin kohor "që i atribuohet gjyqtarit" dhe aparatit gjyqësor për mbylljen përfundimtare të procesit; Jo e gjithë periudha kohore që i atribuohet gjyqtarit brenda një procesi gjyqësor (si pjesë e punës së tij), në kuptimin e përmendur më sipër, mund të konsiderohet automatikisht si tej afatit të arsyeshëm. Në fakt, çdo proces gjyqësor, edhe ai proces që kryhet dhe përfundon "shpejt" ka kohëzgjatjen e tij normale që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë si me kryerjen e disa fazave procedurale ashtu dhe me gjykimet e çështjeve në disa nivele gjykatash, (sipas rastit). Në mënyrë që afatet kohore të konsiderohen të paarsyeshme, nuk mjafton vetëm të merret për bazë e gjithë kohëzgjatja reale e procesit, por duhen verifikuar rast pas rasti veprimet konkrete që janë ndërmarrë në kuadër të këtij procesi dhe nëse këto veprime justifikojnë apo jo vonesën dhe neglizhencen e gjyqtarit*

Gjithashtu gjykata e larte ka orientuar ne lidhje me vonesen ne arsyetimi dhe dorëzimin e vendimeve si nje zvarritje e procesit gjyqësor se se:

*Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, kur përbën rast përsëritës, të rëndë, dhe të pajustifikuar. "Në çdo rast kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar përsa kohë vonesa cënon të drejtën e palëve për të patur një proces që zhvillohet brenda afateve të arsyeshme sipas nenit 6 prg.1 të KDENJ"; Përsa i takon pretendimit për numrin e çështjeve dhe përmasave të vonesës në këto çështje, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar, në momentin që sjellja e gjyqtarit (pra fajti i tij) ka të bëjë me paaftësinë e tij organizatore për të kryer në mënyrën e kërkuar, detyrën e gjyqtarit".*

Nisur nga analiza e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vleresojnë se vonesat e gjyqtarit në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore mund të konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim të nenit 32/1/a si dhe nenit 32/2/c të Ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 dhe do e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në rast se:

- këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara;
- këto vonesa kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë . (sidomos në rastet kur ndaj vendimit që pritet të dorëzohet i arsyetuar është ushtruar ankim);
- këto vonesa nuk justifikohen nga ngarkesa e punës që ka gjyqtari apo nga kompleksiteti i çështjeve që ai ka në shqyrtim;
- këto vonesa nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me gjyqtarin;
- këto vonesa janë jashtë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv;
- këto vonesa kanë cënuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësisë.

Te njejtat parametra gjejmë me vend se duhen zbatuar nga gjykata edhe ne rastet e vonesës se kohezgjatjes se proceseve gjyqesore e duke marre ne konsiderate sa me siper. Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se rastet e marra ne shqyrtim nga Keshilli i Larte i Drejtesise nuk rezulton te jene provuar se jane plotesuar keto kritere ligjore dhe jurisprudenciale per te nisur proceduren disiplinore dhe per te marre masen ndaj paditeses.

Ne keto rrethana te faktit e te ligjit. Gjykata Administrative e Apelit cmon se vendimi Nr. 105 date 21.07.2014, eshte akt i nxjerre ne kundërshtim me ligjin duke qene se ne ligjin procedural nuk percaktohen afate te detyrueshme per kohezgjatjen e proceseve gjyqesore dhe se kriteret e përcaktuara ne Vendimin 199 te Keshillit te Larte te Drejtesise, jane kritere orientuese dhe jo te detyrueshme. Ato kritere duhet te merren ne shqyrtim e te vleresohen ne teresine e tyre dhe nuk mund te merren te ndare nga njeri tjetri. Nuk rezultoi e provuar gjate gjykimit qe gjyqtarja te mos kete organizuar punen, apo te kete neglizhuar ate dhe te kete kryer shkelje te tilla procedurale qe te cojne ne cenimin e imazhit te drejtesise apo qe te kete sjelle pasoja per te drejtat kushtetuese te paleve ne proces për pasojë padia e paraqitur nga paditesja Herila Cela eshte e bazuar ne ligj e prova dhe si e tille duhet pranuar dhe Vendimi Nr. 105 date 21.07.2014 eshte akt i nxjerre ne kundërshtim me ligjin dhe provat.

## **PER KETO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit bazuar ne nenet 10 pika 2 germa "b", 40 pika 1, 41 e 42 te ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" me shumice votash

## **VENDOSI**

-Pranimin e padise.

Shfuqizimin e vendimit Nr.105 dt 21.07.2014 të Këshillit të Lartë të Dretësisë.

-Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.

-Kunder ketij vendimi lejohet rekurs ne Kolegjin Administrativ te Gjykares se Larte brenda 30 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e komunikimit te ketij vendimi.

U shpall sot në Tiranë më 05.12.2014.

**ANETARE**

**Blerona HASA**

DV

**ANETAR**

**Alketina GAZIDEDJA**

DV

**KRYESUESE**

**Rilinda SELIMI**

Kundër

**DV**

**E NJESUAR ME ORIGINALIN**

**KANCELARI**

**LEONARD STRATAJ**